



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Tiranë, datë 20 Janar 2023

RAPORT

**“MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE TË INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË
KULTURORE PËR VITIN BUXHETOR 2022”**

I.HYRJE

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, ent publik me statusin e personit juridik që financohet nga buxheti i shtetit.

Detyra themelore e IKTK-së, është ruajtja, mbrojtja, konservimi, restaurimi dhe vlerësimi i monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale në territorin e Republikës së Shqipërisë. IKTK ndërton të gjithë punën kërkimore-shkencore, ndjek zbatimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e trashëgimisë kulturore, kryen, mbikëqyr dhe kolaudon veprime konkrete mbi monumentet e paluajtshme dhe objektet e luajtshme, pjesë integrale e tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, bën kualifikimin e kuadrit, autorizon, si dhe përcakton kriteret e restaurimit.

Misioni i IKTK-së përfshin gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore material, në përputhje me Ligjin Nr.27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë dhe Muzetë” dhe VKM Nr. 364 datë 29.05.2019 për “Funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”.

Misioni i IKTK-së është të marr të gjitha masat që të siguroj gjurmimin, evidentimin, mbrojtjen, dokumentimin e plotë, konservimin, restaurimin shkencor dhe promovimin e monumenteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. IKTK, aktivitetin e tij e kryen në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, të cilat bazuar në Ligjin 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" veprojnë nën koordinimin dhe mbikëqyrjen e tij.

IKTK-ja është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

✓ ***IKTK-ja vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në fushat e përgjegjësisë, si më poshtë vijon:***

- a) të trashëgimisë kulturore materiale;
- b) të arkeologjisë parandaluese të shpëtimit nëntokësor dhe nënujor;
- c) të pasurisë e peizazhit kulturor.

✓ ***IKTK-ja ka përgjegjësi të organizojë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësi në fushën:***

a) e trashëgimisë kulturore materiale në lidhje me gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale;

b) e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

✓ ***IKTK-ja kryen detyrat, si më poshtë vijon:***

a) monitoron dhe koordinon DRTK-të, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e tyre;

b) konstaton verifikimin ose jo, të interesit kulturor për pasuritë e paluajtshme sipas procedurave përkatëse në ligjin për trashëgiminë kulturore;

c) nëpërmjet sekretarisë teknike kryen verifikimet e natyrës teknike dhe siguron nga kërkuesit informacione të tjera shtesë në funksion të vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, lidhur me kërkesat për ndërhyrje;

ç) vendos pezullimin e menjëhershëm të ndërhyrjeve kur me propozim të institucioneve të specializuara ose kryesisht konstaton kryerjen e punimeve në kundërshtim me ligjin;

d) monitoron ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve të licencuara;

dh) kryen formimin e vazhdueshëm të personave të pajisur me licenca në fushën e projektimit e të zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale, veprimtarisë arkeologjike;

e) kryen studime për shtrirjen e zonës së mbrojtur për pasuritë kulturore të paluajtshme ose grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme;

ë) vendos masat e mbrojtjes indirekte, sipas procedurës së parashikuar në ligj;

f) propozon procedurën për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike;

g) koordinon planet e zhvillimit, të projekteve restauruese dhe konservuese, projekteve kërkimore-shkencore të NJAKPA-ve;

gj) ndjek gjetjet rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore ose punimeve të tjera të çfarëdollojshme dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave, sipas procedurës së parashikuar në ligj;

h) nëpërmjet punonjësit të autorizuar pezullon punimet që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në rastin e zbulimeve të rëndësishme;

i) regjistron njoftimet për gjetjet rastësore detare dhe nëntokësore;

j) studion dhe përcakton kufijtë e zonave të mbrojtura të pasurive kulturore;

k) konsulton ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rijetëzim për vlerat kulturore të paluajtshme;

l) së bashku me IKRTK-në harton masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin dhe qarkullimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve muzeore;

ll) kryesisht ose me propozim të institucioneve të specializuara të njësive të qeverisjes qendrore ose të vetëqeverisjes vendore fillon procedurën e vlerësimit, duke verifikuar ekzistencën e interesit të veçantë publik për pasuritë e peizazhit kulturor për pasuritë e paluajtshme dhe për zonat për të cilat është marrë iniciativa;

m) lëshon lejet e peizazhit kulturor pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, si dhe i sugjeron Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale vendosjen e distancave, masave/hapësirave dhe variante të projektit në fazë ekzekutimi të nevojshme për ruajtjen e vlerave të peizazhit;

n) përgatit dhe realizon në mënyrë periodike botime të ndryshme shkencore, albume dhe udhërrëfyes;

nj) nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim formon dhe përditëson njohuritë e restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara;

o) nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim harton dhe zbaton programe të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

p) çdo detyrë tjetër të përcaktuar me ligj.

Pranë KKTKM-së funksionojnë këto struktura administrative:

1. Këshilli teknik;
2. Sporteli unik;
3. Sekretaria teknike.

1. **Këshilli teknik** është organ kolegjal seleksionues, vlerësues e vendimmarrës, që ka në përbërje 7 anëtarë, të cilët janë pjesë e 15 anëtarëve të KKTKM-së. Këshilli teknik kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe vepron si trupë shqyrtuese dhe seleksionuese e përputhshmërisë së kërkesave të paraqitura pranë KKTKM-së. Vendimi ose relacioni që i dërgohet KKTKM-së nga ana e Këshillit teknik firmoset nga kryetari.

2. **Sporteli unik** është pjesë e strukturës administrative pranë IKTK-së, ku depozitohen të gjitha kërkesat për aplikim, për të cilat është kompetente KKTKM-ja. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

3. **Sekretaria teknike** është pjesë e strukturës administrative të IKTK-së, në funksion të KKTKM-së, e cila administron kërkesat dhe përgatit dokumentacionin për vendimmarrje të KKTKM-së. Detyrat, funksionet dhe mënyra e ushtrimit të tyre përcaktohen në rregulloren për veprimtarinë e KKTKM-së.

II. OBJEKTIVAT

II.1.Përmirësimi i kuadrit ligjor

a) Të angazhohet në hartimin e projekt akteve në bazë të Planit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve (PPAP), për vitin 2022 nën koordinimin e Ministrisë së Kulturës; (Të gjithë sektorët).

b) Hartimi i propozimit për tarifat e shërbimeve të ofruara nga IKTK dhe paraqitja e tyre pranë Ministrisë së Kulturës, për përfshirjen në Urdhrin e Përbashkët të saj me Ministrinë e Financave; (Të gjithë sektorët)

- c) Hartimi i udhëzuesit për menaxhimin dhe administrimin e tarifave të shërbimit të IKTK; (Të gjithë sektorët)
- d) Hartimi i Strategjisë së Riskut 2022-2024 për IKTK; (Të gjithë sektorët)
- e) Përmirësimi i kuadrit ligjor me akte ligjore dhe nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (DMK + DSHA):
 - ✓ VKM për deklarimin e interesit kulturor;
 - ✓ VKM e re “Për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore në grup (ansambël / qendër historike) (SQHATP);”
 - ✓ VKM e rishikuar “Për deklarimin e interesit kulturor të pasurive kulturore në grup (ansambël / qendër historike) (SQHATP);
 - ✓ VKM për zonifikimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Beratit, Vlorës dhe Sarandës dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre.

II.2.Partneritete dhe Marrëveshje bashkëpunimi (IKTK)

- a) Rritja e fondeve të përthithura nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet realizimit të suksesshëm të partneriteteve të lidhura për projektet me fonde IPA;
- b) Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet IKTK-së dhe Institucioneve të arsimit të lartë, si dhe organizmave që veprojnë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet finalizimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.

II.3.Programe shtetërore dhe ndërkombëtare në trashëgimi kulturore

- a) Bashkëpunim i drejtpërdrejtë me INRAP (Institut National de Recherches Archéologiques Préventives), Francë dhe Ministrinë e Kulturës Francë për organizimin e programit/aktivitetit “DITËT EUROPIANE TË ARKEOLOGJISË” në datat 17-18-19 qershor 2022, ku IKTK ishte në rolin e koordinatorit për Shqipërinë;(DSHA)
- b) Pjesëmarrje me temë në konferencën Ndërkombëtare të EAC (European Archaeological Council) në takimin vjetor të 23-të me temë “Archaeology and the Natural Environment”, në datat 24-25 mars 2022, në Vienë, Austri; (DSHA)
- c) Pjesëmarrje me temë në konferencën Ndërkombëtare të EAA (European Association for Archaeologists) në takimin vjetor të 28-të me temë “REINTEGRATION”, në datat 31 Gusht 2022 - 3 Shtator 2022 , në Budapest, Hungari;(DSHA)

II.4.Marrëdhënie me UNESCO-n në kuadër të mbrojtjes së Pasurive Botërore në Shqipëri dhe në kuadër të zbatimit të Konventës së Trashëgimisë Botërore

- a) Realizimi i draftit final të Planit për Menaxhimin e Integruar për qendrat historike Berat dhe Gjirokastrë. (IKTK)

I.5.Aktiviteti i IKTK-së në përputhje me Planin e punës 2022

- a) Pasurimi i listës së pasurive kulturore nëpërmjet një procesi studimi të thelluar kërkimor-shkencor.
- b) Rritja e cilësisë dhe sasisë së hartimit të projekteve të restaurimit për objekte pasuri kulturore në territorin e Shqipërisë.

- c) Rritja e cilësisë së kryerjes së procesit të mbikëqyrjes për objektet pasuri kulturore në zbatim të akteve ligjore në fuqi.
- d) Rritja përafërsisht në masën 10% të shërbimeve arkeologjike në terren (gërmime/sondazhe, dokumentime arkeologjike, vëzhgime arkeologjike, verifikime në terren dhe gjetje rastësore), me synim përmbushjen e veprimtarisë dhe misionit, si dhe rritjen e burimeve të financimit të DSHA-IKTK.
- e) Ndjekja dhe zbatimi në kohë i marrëveshjeve tre palëshe për shërbime monitorimi arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve si dhe mbikëqyrjes arkeologjike gjatë realizimit të sondazheve/gërmimeve arkeologjike, në përgjigje të kërkesave dhe ritmeve të zhvillimit të projekteve nga subjektet aplikues.

II.6. Monitorime arkeologjike të subjekteve private të licencuar në arkeologji- 25 në total

II.7. Sekretaria Teknike e Këshillit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale – KKTKM

- a) Përforcimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore me qëllim menaxhimit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Sekretaria Teknike e IKTK-së;
- b) Të mundësojë publikimin brenda një afati sa më të shkurtër të mundshëm të Vendimeve të KT-së, KKTKM-së, Regjistrave Publikë si dhe njoftimeve të ndryshme në faqen web të IKTK-së;

II.8. Programe për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe Kërkimi Shkencor

- a) Mundësia e financimit të kurseve të trajnimit / Atelieve të Restaurimit, të propozuara nga Qendra Rajonale për Konservim dhe Restaurim e Evropës Juglindore, nëpërmjet përmirësimit të projekt propozimeve dhe rritjes së numrit të kërkesave për financim.

II.9. Botime dhe Promovime

- a) Të sigurojë vazhdimësinë e botimit të revistës periodike “Monumentet” Nr.61 organ i IKTK-së, nëpërmjet rritjes së numrit të artikujve shkencor të hartuar nga stafi i IKTK-së (Për këtë vit do të hartohen 8 artikuj shkencorë nga IKTK: 2 SQHATP +2 SVA+ 3 SAAM+1 QRKREJ);
- b) Të realizojë numri i parë i “Revista Arkeologjike”, botim shkencor që do të shërbejë për të publikuar punën kërkimore të Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik pranë IKTK, si dhe artikuj të tjerë nga institucione shtetërore të specializuara apo individë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e trashëgimisë arkeologjike.

II.10. “Digjitalizimi i arkivit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe krijimi i një protokolli për evakuimin e arkivit në raste fatkeqësie/emergjence”

- a) Realizimin e skanimit të kartotekës së Arkivit Teknik të IKTK-së, në masën 80 %; (Arkiva Teknike)

III. BUXHETI I IKTK-së

IKTK është pjesë e Programit të Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë të Programit 08220, pjesë e Ministrisë së Kulturës.

Programi financiar 2022 synon në ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet konservimit, restaurimit dhe rehabilitimit të objekteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore materiale, bazuar në nisur nga emergjenca për të ndërhyrë në objekte me rëndësi të veçantë për kulturën kombëtare që rrezikojnë të humbasin vlerat e tyre të rralla, për të cilat identifikohemi si një ndër popujt më të vjetër të Ballkanit dhe në zhvillimin e Turizmit Kulturor në përgjithësi, si dhe në kuadër për të përmbushur.

Realizimi dhe monitorimi i shpenzimeve të tij, për vitin 2022 është bazuar në zbatim të Ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) kreu 8, neni “Monitorimet”, Udhëzimit Nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Për vitin 2022, niveli i realizimit të buxhetit në vlerë totale për Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore është **65,828, mijë lekë**, ose në masën **97%** të buxhetit të planifikuar. Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlera e financuar në buxhetin 2022 dhe niveli i realizimit për çdo artikull në masë absolute dhe relative.

Tabela nr.1

Kapitulli	Kodi Projektit	Përshkrimi	Artikulli	Plani Vjetor/ 2022 ne lekë	Fakti i shpenzimeve 2022 ne lekë	Niveli i realizimit % plan-fakt
1	91202AA	Paga	600	42,206,400	41,747,805	99%
1	91202AA	Sigurimet	601	7,142,900	6,979,327	98%
1	91202AA	Shpenzime Operative	602	11,461,000	11,380,746	99%
1	91202AA	Transferime korente të huaja /Anëtarësime	605	140,000	84,700	61%
1	91202AA	Ndihme, Transferime tek individët	606	948,715	898,225	95%
1	19AD803	Monitorimi Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit	230	0	-	0%
1	91202AA	Blerje pajisje kompjuterike	231	3,751,000	3,568,800	95%
1	18CF309	Garanci punimesh	231	724,664	143,006	20%
4	91202AA	Plani I menaxhimit Berat, Gjirokastër UNESCO (2021)	602/4	1,655,285	1,025,570	62%
TOTALI				68,029,964	65,828,179	97%

- a) **Zëri i shpenzimit "Paga"** për vitin 2022 është realizuar në masën 99 %, në raport me planin e parashikuar në vlerë 41,747 mijë lekë. Kjo diferencë është krijuar përgjatë vitit 2022, pasi ka patur mungesa të punonjësve në organikë si dhe lëvizje të stafit (largime).
- b) **Zëri i shpenzimit "Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësorë"** për vitin 2022 është realizuar në masën 98 %. Ky zë i shpenzimit në buxhet është i lidhur me zërin e shpenzimit "Paga" për të cilin argumentimi është i njëjtë.
- c) **Zëri i shpenzimit " Shpenzime Operative "** për vitin 2022 është realizuar në masën 99 %. Ky zë i shpenzimit në buxhet është përdorur për realizimin e kërkesave dhe nevojave të Institucionit tonë për blerje mallra dhe shërbime, duke krijuar kushte pune më të mira për punonjësit.

Duhet të evidentojmë, se me këtë fond janë:

- ✓ Riparuar pajisjet elektronike e rritur kapacitetet e njësive kompjuterike,
- ✓ Botuar dy revista studimore: "Monumente nr.61" dhe revista e parë "Arkeologjia nr.1",
- ✓ Furnizuar me kuti arkivi të nevojshme për dorëzimin e dokumenteve arkivore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave,
- ✓ Abonuar në programin "Autocad" për 4-njësi kompjuterike,
- ✓ Abonuar në platformën Zoom,
- ✓ Realizuar pagesat e honorarëve për anëtarët e KKTKM-së,
- ✓ Furnizuar me materiale për restaurimin e veprave të artit, e shumë mallra e shërbime periodike rutinë të planifikuara në buxhetin e vitit 2022.

Në këtë zë të shpenzimeve, IKTK ka të planifikuar në kapitullin 6, edhe "Planin e menaxhimit Berat, Gjirokastër UNESCO", që për vitin 2022 është realizuar në masën 62%, për arsye se nuk janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara, por që fondet mbarten në vitin 2023.

- d) **Zëri i shpenzimit " Transferta korente te Huaja /Anëtarësime "** për vitin 2022 është realizuar në masën 61%. Ky zë i shpenzimit në buxhetin e Institucionit tonë ka një nivel realizimi të ulët. Kjo, sepse niveli i shpenzimeve është i lidhur ngushtësisht me pjesëmarrjen fizike të punonjësve në konferenca. Situata e post-pandemisë nga Covid 19, ka vijuar me organizime të aktiviteteve e konferencave on-line, e cila bëri që niveli i kërkesave për pagesa të kuotave të pjesëmarrjes të jetë i ulët.
- e) **Zëri i shpenzimit " Transferta për Bux.Fam.&Individ "** për vitin 2022 është realizuar në masën 95 %. Ky zë i shpenzimit në buxhet është përdorur për realizimin e shpërblimit në rast fatkeqësie, ndihme të menjëhershme, pagesën e shpenzimeve të telefonisë celulare për titullarin e Institucionit si dhe zbatimit të VKM nr.898 datë 29.12.2022 "Mbështetja financiare e menjëhershme të punonjësve të Njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të Arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës", dhënë nga Qeveria në fund vitin 2022.
- f) **Zëri i investimit " Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit "** nuk është realizuar.

Në zbatim të VKM-së nr. 213, datë 11.03.2020 "Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore", në pikën 3 të të cilit citohet: -

“Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara, pas përfundimit të procedurave në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e fondit për rindërtimin dhe trashëgohen në vitin pasardhës”, fondet pashpenzuara në mbyllje të vitit 2021 janë transferuar për vitin 2022.

Pas çeljes së fondit, IKTK, i është drejtuar Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkisë Durrës, si institucione/njësi zbatuese të projekteve të rindërtimit, me shkresën nr.836 prot. datë 12.05.2022, për informacion të përditësuar për çdo zonë, mbi ecurinë e zbatimit të punimeve për “26 Zonat e Reja të Zhvillimit”, në mënyrë që IKTK, si autoritet kontraktues, të përcaktojë vijimin ose jo të procedurave për monitorimin arkeologjik të punimeve. Meqenëse nga këto institucione nuk është marrë asnjë përgjigje, IKTK, në përputhje me detyrimin ligjor për mbikëqyrjen arkeologjike të përcaktuar në ligjin Nr. 27/2018 si dhe Vendimeve të KKTKM me Nr. 383, datë 06.11.2020, Nr. 402 datë 18.11.2020, Nr. 453 datë 03.12.2020 dhe Nr. 454 datë 03.12.2020, për “26 Zonat e Reja të Zhvillimit” në kuadër të procesit të rindërtimit si pasojë e tërmetit të 26 Nëntorit 2019, ka realizuar procesin e inspektimit në terren për 26-zonat në datat 16 deri në datë 18.05.2022, për verifikimin e ecurisë së punimeve të projekteve për “26 Zonat e Reja të Zhvillimit”. Nga inspektimi në terren, rezulton se procesi i punimeve të gërmimit ka përfunduar për 21 zonat e reja të rindërtimit dhe ende nuk ka filluar puna për 5 zonat. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore i ka drejtuar Ministrisë së Kulturës me shkesën nr.1004 datë 06.06.2022, “Kërkesë për pakësim fondi investimesh me objekt: “Kryerja e Monitorimit Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit” në kuadër të procesit të rindërtimit si pasojë e tërmetit të 26 Nëntorit 2019”.

Për këtë arsye, është kërkuar pakësimi i fondi, kërkesë e cila u realizua me VKM nr.869 date 27.12.2022 *“Për disa ndryshime në VKM-së nr. 213, datë 11.03.2020 “Për caktimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore si njësi zbatuese, dhe për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e restaurimit/rindërtimit të pasurive kulturore”*

- g) Zëri i investimit “Blerje pajisje kompjuterikë”** për vitin 2022 është realizuar në masën 95 %, duke i ofruar punonjësve kompjuter dhe pajisje të standardit të përcaktuar nga AKSHI.
- h) Zëri i investimit “Garanci punimesh”,** për vitin 2022 është realizuar në masën 20 %. Është realizuar i plotë projekti investimit për “Para financim për projektin IPA "MoNa", "Realizimi i punimeve të konservimit dhe drenazhimit në Portës me kulla dhe Nimfeu, qyteti antik Butrint" faza I+II, në vlerën, 143.000 lekë, pasi marrjes së Certifikatës së përhershme të punimeve. Fondi i garancisë për “Restaurime i kishës së Shën e Premtes në fshatin Valsh", Faza II, Gjinar, Elbasan” në vlerën 193,701 lekë dhe “Restaurime I kishës së Shën Ilias Stegopull” në vlerën 387,957 nuk është realizuar për arsye se nuk ka marrë akoma Certifikatën e përhershme të punimeve.

Për vitin 2022, niveli i realizimit të buxhetit në vlerë totale për Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore është **65,828**, mijë lekë, ose në masën 97% të buxhetit të planifikuar. Për gjatë vitit 2022, me qëllim maksimizimin e përdorimit të fondeve dhe mënjanimin të riskut të mospërdorimit të tyre, janë kërkuar Ministrisë së Kulturës ndryshime (pakësim dhe shtesa) të realizuara gjatë vitit dhe të pasqyruara në Regjistrin e Fondeve Buxhetore 2022, në tabelën si më poshtë vijon:

REGJISTRI I FONDEVE BUXHETORE 2022-IKTK

Tabela nr.2

000/lekë

Kapitulli	Çelje Buxheti Shkresa Numër 6706/4 date 26/01/2022 sipas I log. Ekonomike	Vlera ne leke	Shkresa nr.1169/6 date 28/04/2022	Paksime Shkresa nr 1112/5 date 15/04/2022	Çelje shkresa nr2250/2 date 05/05/2022	Plan 30 prill 2022	Shresa Shkresa 4299/1 date 30.8.2022	Pakësimi Shkresa 3726/1/16 dt 12.7.2022	Plan Gusht 2022	Shresa Shkresa 5256/1 date 06.10.2022	Plani Tetor 2022	Pakësimi Shkresa 5297/2 date 06.10.2022	Plani Tetor 2022	Pakësimi Shkresa 5010/2 date 03.10.2022	Pakësimi me nr.5212/4 date 7.11.2023	Plani 1 tetor 2022	Pakësimi me nr.6106 date 7.11.2022	Plani Nëntor	Pakësimi me shkresën 6118/3 15.11.2022	Plani Nëntor	Çelje Shkresa nr.5866/2 date 8.11.22	Pakësimi Shkresa 6236/6 date 22.11.2022	Ndihma ekonomike shkresa nr.6395/1 dt.21.11.22	Shkresa 6108/10 date 23.11.2022--	Ndihma menjëhershme	VKM nr.869 date 27.12.2022	Plani Dhjetor	
1	6000000	48,000	(1,800)			46,200		(785)	45,415		45,415	(1,218)	44,197	(690)	-	43,507	(948)	42,559		42,559		(351)						42,208
1	6010000	8,000	(300)			7,700		(131)	7,569		7,569	(7)	7,562	(118)	-	7,444	(222)	7,222		7,222		(77)						7,145
1	6020000	16,000	(741)	(48)		15,211			15,211		15,211		15,211		(300)	14,911	(2,700)	12,211	(300)	11,911								11,911
1	6050000	240				240			240		240		240			240	-	240		240					(100)			140
1	6060000			48		48	50		98	50	148		148			148	-	148		148			50	0	750			948
1	2300000				13,521	13,521			13,521		13,521		13,521			13,521	-	13,521		13,521						(13,521)		-
1	2310000					-			-		-		-			-		-		-	3,751	0						3,751
		72,240	(2,841)	-	13,521	82,920	50	(916)	82,054	50	82,104	(1,225)	80,879	(808)	(300)	79,771	(3,870)	75,901	(300)	75,601	3,751	(428)	50	(100)	750	(13,521)		62,352


Në tregues analitik, plani dhe realizimi sipas artikujve buxhetor paraqitet në formë tabelore grafike, si më poshtë:

TË DHËNAT BUXHETORE (PLAN – FAKT), SIPAS ZËRAVE TË ARTIKUJVE PËR PERIUDHËN JANAR – DJHJETOR 2022

Tabela nr.2


Kapitulli	Kodi Projektit	Pershkrimi	Artikulli	Plani fillestare vjetor 2022 ne lekë	Plani Vjetor/ Rishikuar 2022 ne lekë	Struktura artikujve ne % sipas planit	Fakti I shpenzimeve 2022 ne lekë	Struktura artikujve ne % sipas faktit	Niveli I realizimit % plan-fakt
1	91202AA	Paga	600	48,000,000	42,206,400	62.0%	41,747,805	63%	99%
1	91202AA	Sigurimet	601	8,000,000	7,142,900	10.5%	6,979,327	11%	98%
1	91202AA	Shpenz. Operative	602	16,000,000	11,461,000	16.8%	11,380,746	17%	99%
1	91202AA	Antarsime	605	240,000	140,000	0.2%	84,700	0%	61%
1	91202AA	Ndihme	606		948,715	1.4%	898,225	1%	95%
1	19AD803	Monitorimi Arkeologjik në 26 zonat e reja të Zhvillimit	230	13,521,750	0	0%	-	0%	0%
1	91202AA	Blerje paisje kompjuterike	231	-	3,751,000	5.5%	3,568,800	5%	95%
1	18CF309	Garanci punimesh	231	724,664	724,664	1%	143,006	0%	20%
4	91202AA	Plani I menaxhimit Berat, Gjirokastrer UNESCO (2021)	602/4	1,655,285	1,655,285	2%	1,025,570	2%	62%
TOTALI				88,141,699	68,029,964	100%	65,828,179	100%	97%

Grafiku nr.1




Plani sipas strukturës të artikujve të çelura dhe realizimit në fakt për periudhën janar –dhjetor 2022 grafikisht paraqitet:

Grafiku nr.2.



Grafiku nr.3



PRODUKTET PER IKTK JANË:


Tabela nr.3

Nr .	Emërtimi procesit	Struktura përgjegjëse	Produkti	Plani Janar - Dhjetor 2022	Produkte shtese 2022	Realizimi Janar – Dhjetor 2022	% realizimi
1	Hartim projekti	IKTK	Projekte te Hartuar.	62		32	52%
2	Relacionet përmbledhëse për çdo aplikim të depozituar pranë IKTK-së. Prezantime në kuadër të mbledhjeve të organizuara për Këshillin Teknik dhe Këshillin Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.	IKTK	Relacion Projekti.	500		575	115%
3	Shqyrtim i aplikimeve për pajisje me licenca individuale për person fizik/juridik për ndërhyrje në pasuritë kulturore materiale dhe veprimtarinë arkeologjike.	IKTK	Person Fizik/Juridik të licencuar.	36		109	303%
4	Mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve të restaurimit	DMK	Projekte të Restauruara.	60		55	92%
5	Shqyrtim dhe Vërtetim në lidhje me kërkesat e individëve apo subjekteve mbi statusin e pasurive kulturore materiale.	IKTK	Vërtetime mbi statusin e pasurive.	24		24	100%
6	Akte nënligjore të shqyrtuara apo hartuara në bashkëpunim me MK dhe të tjerë.	IKTK	Akte ligjore të shqyrtuara.	5		5	100%
7	Hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë.	IKTK	Marrëveshje.	4		4	100%
8	Përmirësimi i sistemit të gjendjes së pasurive kulturore nëpërmjet digjitalizimit dhe ruajtjes në database. Hartimi dhe prodhimi i kartelave digjitale, në bashkëpunim me CHWB (2022-2023)	IKTK	Kartela digjitale të pasurive kulturorë	400		1	0%
9	Asistencë me konsulentë teknike apo administrative me palë të treta.	Spektori i Qendrave Historike, Arkitekturës së Traditës dhe Peizazhit +Spektori Antiko Mesjetar	Asistencë me konsulentë teknike apo administrative me palë të treta.	30		30	100%
10	Verifikim interesi kulturor	Spektori i Arkitekturës Antike dhe Mesjetare	Verifikim interesi kulturor.	10		5	50%
11	Mirëmbajtja e faqes zyrtare të IKTK-së	IKTK	Faqe Website.	1		1	100%
12	Shërbim Arkivi Teknike (kërkesa nga Institucionet e Trashëgimisë dhe të tjerë)	IKTK	Shërbimi sipas Aplikimeve.	150		150	100%
13	Arkivim pranë Arkivit Teknik i dosjeve të projekteve	IKTK	Dosje të arkivuara.	100		108	108%
14	Arkivim pranë Arkivit Teknik i dosjeve supervizime/ kolaudime.	IKTK	Dosje të arkivuara.	10		5	50%
15	Skanim i dosjeve për procesin e Digjitalizimit të Arkivit Teknik.	IKTK	Dosje të skanuara.	1100		1700	155%
16	Trajtim i pikturave murale, mozaikëve dhe objekteve prej druri.	Spektori i veprave të artit	Piktura Murale të trajtuara.	6		6	100%
17	Botimi i REVISTES "Monumentet" dhe "Arkeologjia"	IKTK	Botime.	2		2	100%
18	UNESCO / Ndjekja e zbatimit të Vendimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore për sitet e trashëgimisë botërore	SQRKREJL	Raport i miratuar për gjendjen e Konservimit për Trashëgiminë Kulturore.	6		6	100%
19	Menaxhim / zbatim i projekteve me fonde UNESCO - Plani i Menaxhimit i Integruar për Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastrë	IKTK	Draft i pare i PMI i hartuar	1		1	100%

20	Termet e Referencës të hartuara dhe të miratuara në KKTKM	IKTK	ToR i miratuar	1		1	100%
21	Konsultim me Palët e Interesit dhe komunitetin për PMI Berat-Gjirokastrë	IKTK	Konsultim i realizuar	2		2	100%
22	Realizim i tre Workshop-eve për PMI Berat-Gjirokastrë	IKTK	Staf i trajnuar	3		2	67%
23	Verifikim në terren	SSHANN	Verifikim në terren	30		29	97%
24	Pjesëmarrje në konferencën vjetore të 23-të në Viene, Austri, mars 2022	DSHA	Përfaqësim i Institucionit në aktivitete ndërkombëtare.	1		1	100%
25	Sondazhe dhe gërmime arkeologjike/ dokumentime	SSHANN	Gërmime/dokumentime të kryera	3		2	67%
26	Ndjekje e gjetjeve rastësore	SSHANN	Ndjekje rastësore.	10		13	130%
27	Mbikëqyrje arkeologjike në terren	SMVANN	Mbikëqyrje arkeologjike.	13		24	185%
28	Konferenca EAC- European Archaeological Council	DSHA	Përfaqësim në Konferencë.	1		1	100%
29	Konferenca EAA - European Association of Archaeologists	DSHA	Përfaqësim në Konferencë.	1		1	100%
30	Regjistrim i dokumentacionit, të marrë nga aplikimet nëpërmjet sistemit on-line i detajuar edhe sipas aplikimeve shoqëri/individ të licencuar në arkeologji	Sektori i Platformës Digjitale të Trashëgimisë Kulturore	Projekte Zhvillimi, të aplikuar dhe regjistruar në Sistemin WebGIS.	120		173	144%
31	Përpunimi i dokumentacionit të projekteve të miratuara dhe publikimi për publikun në faqen e sistemit WebGIS Arkeologjia	Sektori i Platformës Digjitale të Trashëgimisë Kulturore	Pasurimi i hartës digjitale të arkeologjisë me projektet e miratuara	40		47	118%
32	Pjesëmarrje e punonjësve në Trajnim ndërkombëtar për trashëgimisë kulturore	IKTK	Staf i trajnuar	10		8	80%
33	Konferenca 2 ditore për arkeologjinë nënujore në bashkëpunim me ICUA Zadar, UNESCO	DSHA	Përfaqësim i Institucionit në aktivitete ndërkombëtare.	1		0	0%
34	Aktivitet ndërkombëtar që organizohet nga INRAP dhe MINISTRIA E KULTURES, FRANCË, "DITËT EUROPIANE TË ARKEOLOGJISË" 16-17-18 Qershor 2022	IKTK	Përfaqësim i institucionit në aktivitete ndërkombëtare.	1		1	100%
35	Akt-marrëveshje të lidhura në kuadër të Monitorimit Arkeologjik nga IKTK	DSHA	Marrëveshje të lidhura	15		17	113%
36	Menaxhim / zbatim i projekteve me fonde të BE-së	IKTK	Projekte IPA	2		1	50%
37	Blerje pajisjesh kompjuterike	IKTK	Përmirësim i kushteve të punës	0	12	12	100%
38	Abonime në programin Autocad	IKTK	Përmirësim i kushteve të punës	0	4	4	100%
39	Menaxhimi i projekteve në kuadër të Bonusit të Rrjetëzimit	IKTK	Projekte të shqyrtuara, punime të mbikëqyrura & kolauduara.	0	40	40	100%
TOTALI				2,761	56	3,198	114%

Siç evidentohet edhe nga të dhënat e tabelës, nga 2,761 produkte të planifikuara për vitin 2022, janë shtuar 56 produkte të reja. Në total, gjatë vitit 2022, janë realizuar 3,198 produkte, ose në masën 114 % e planifikimit të gjithë vitit.

Grafiku nr.4



Nga niveli i realizimit të produkteve vërejmë se një pjesë e tyre janë realizuar në nivele të kënaqshme dhe parashikimi i tyre ka lidhje me aplikimin për shërbime (restaurimi/rikonstruksioni/monitorim arkeologjik, sondazhe, gjurmime, etj.) në sistemin on-line të aplikimeve për leje apo licencime.

Një pjesë tjetër e produkteve janë realizuar në masën e parashikuar apo tejkaluar, dhe një pjesë janë realizuar nën nivelin e parashikuar.

Arsyet e këtij mosrealizimi sipas produkteve në tabelë janë:

a) “Hartim projekti” me 52% nivel realizimi, argumentohet se IKTK është institucion i cili ushtron detyrat e tij në bazë të planit vjetor por edhe kërkesave dhe zbatimit të programeve të Ministrisë së Kulturës dhe grupeve të punës ndërinstitucionale. Sa i përket viti 2022, institucioni ka pasur ngarkesë të shtuar lidhur me Programin “Bonusi i Rijetëzimit” përfshirë këtu shqyrtimin e aplikimeve/projekteve në sistemin E-Leje, gjithashtu ndjekjen e procesit të zbatimit të punimeve mbikëqyrje – kolaudim. Ndërkohë për shkak të sulmit kibernetik, pjesë e konsiderueshme e kompjuterëve të IKTK-së dolën jashtë funksionit dhe programet e përpunimit të projekteve u çaktivizuan. Sa i përket programeve (software) u morën masat për blerjen e tyre për të vijuar sipas planit vjetor të punës. Gjatë këtij viti, institucioni edhe pas thirrjeve për vende të lira pune për staf teknik, ende është në mungesë të stafit teknik të cilët janë përgjegjës për hartimin e projekteve.

Vlen të theksohet se stafi teknik për shkak të numrit të madh të aplikimeve në sistem ka shqyrtuar 15% më tepër nga planifikimi.

b) “Përmirësimi i sistemit të gjendjes së pasurive kulturore nëpërmjet digjitalizimit dhe ruajtjes në database. Hartimi dhe prodhimi i kartelave digjitale, në bashkëpunim me CHWB (2022-2023)”-0% Ky produkt ka realizuar objektivin e tij sa i përket realizimit të përditësimit sa i përket të dhënave të nevojshme që duhet të ofrojnë kartelat e pasurive kulturore materiale të paluajtshme dhe është në

procesin ku pritet prokurimi nga ana e CHWB për ngritjen e sistemit digjital të ruajtjes dhe analizimit të të dhënave. Vetëm pas përfundimit të këtij procesi mund të vijohet me hedhjen e të dhënave të kartelave në sistem sipas një plani i cili do paracaktohet duke filluar me DRTK Berat dhe DRTK Gjirokastrë. Ndërkohë edhe pse nuk kemi produkt të përfunduar kartele, shumë nga të dhënat që do të përmbajnë kartelat digjitale janë hartuar paraprakisht gjatë kësaj periudhe nga ana e IKTK-së dhe DRTK-ve.

- c) Verifikim interesi kulturor me 50% nivel realizimi, argumentohet se për këtë produkt, IKTK-ja ka ndërmarrë fushata inspektimi në terren për disa objekte/qendra historike, ka studiuar dhe analizuar vlerat e tyre, por për një pjesë të këtyre shqyrtimeve është konkluduar në mungesë të interesit kulturor për shkak të mungesës së vlerave dhe autenticitetit të tyre. Sa i përket pjesës tjetër ato mbeten në proces shqyrtimi deri në momentin e daljes së akteve nënligjore për shpalljen e interesit kulturor..
- d) Arkivimi pranë Arkivit Teknik i dosje supervizime/ kolaudime me 50% nivel realizimi, argumentohet me mos dorëzimin e dosjeve nga specialistët e sektorëve meqë janë në proces dorëzimi. Gjatë vitit 2022 janë dorëzuar 5-dosje nga specialistët e sektorëve përkatës të përmbajtjes, në cilësinë e mbikëqyrësit apo kolaudatorit. Parashikimi për vitin 2022, 10 dosje është bere mbështetur në vitin paraardhës 2021. Numri i dosjeve te supervizim/kolaudimit varet nga numri i objekteve te zbatuara.
- e) Realizim i tre Workshopeve për PMI Berat-Gjirokastrë -67% nivel realizimi, argumentohet se edhe pse janë realizuar 2 workshope të suksesshme të parashikuara në qytetet e Beratit dhe Gjirokastrës për koordinimin me palët e interesuara dhe dakortësimin e objektivave të këtij plani, Workshop-i i tretë i parashikuar është shtyrë për vitin 2023 si rrjedhojë i shtyrjes së kontratës me donatorin UNESCO, si dhe deri në përfundimin e PMI. Ky proces kërkon koordinim me shumë institucione paralelisht dhe mbledhje të të dhënave të nevojshme për përfundimin e këtij plani. IKTK-ja në këtë proces ka rolin e koordinatorit të këtij projekti dhe mbledhja e të dhënave të nevojshme kërkon kontribut të gjithë palëve të interesit, gjë e cila sjell dhe vonesa në përmbledhjen dhe përmbylljen e këtij procesi.
- f) Menaxhim / zbatim i projekteve me fonde të BE-së -50% nivel realizimi, argumentohet se zbatimi i projekteve IPA është proces në vazhdimësi deri në përmbylljen e projektit. Gjatë vitit të kaluar është mbyllur projekti MoNa dhe vijon Projekti 3C i cili ka pasur një kohëzgjatje 3-vjeçare. Projekti 3C është shtyrë nga të gjithë partnerët në projekt dhe është miratuar nga Joint Secretariat. Ky projekt vazhdon zbatimin e tij gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2022 janë bërë 3-shtesa në emërtimin e produkteve sipas proceseve të planifikuara në fillim vitin 2022, e pasqyruar në rritjen me 56 produkte që i përkasin:

1. Blerje pajisjesh kompjuterike,
2. Abonime në programin Autocad,
3. Menaxhimi i projekteve në kuadër të Bonusit të Rijetëzimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Eugen KALLFANI

Konceptoi: Nedina Laçi

Konfirmoi: Afrida Domnori